

BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 41 datë 10/03/2020

“ PËR RISHIKIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DIBËR PËR VITIN 2020”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 18, 34, 40, 41, 54, shkronja “dh”, 55 pika 3, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, keu VII, nenet 39-41 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, VKM nr.620 datë 26.10.2018 “Për propozimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”.

Udhëzimi plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” dhe anekset plotësuese (Informacion mbi nivelin e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Manuali i instrumentit të Planifikimit financiar), Udhëzimin plotësues nr.6/3 datë 10.07.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e buxhetit vendor” me anekset plotësuese, si dhe në ligjin nr.88/2019 datë 88/2019 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Dibër më datë 10/03/2020 miratoi me 16 vota pro, kundër — vota, abstenim —:

Vendosi:

- I. Miratimin e rishikuar të buxhetit vjetor të institucionit së Bashkisë Dibër për vitin 2020 për efekt të ndryshimeve nga pagesat e kryera të datuara në vitin 2019.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Inva TRUPJA

KRYETAR KËSHILLIT BASHKIAK

Sokol SAVA